

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/I-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësoredhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Jelena Krivokapić, anëtarë, me bashkepunëtor profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **Palës ankuese** :

**Lj. R.** Republika e Serbisë

**Kundër Palës përgjegjëse në ankesë:**

**S. T.**, Prishtinë

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/270/2014 të datës 17 Dhjetor 2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA...), pas këshillimit të mbajtur më 12 Qershor 2019, mori këtë:

#### **AKTGJYKIM**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e **Lj. R.** e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/270/2014 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA...) i datës 17 Dhjetor 2014,
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/270/2014 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA...) i datës 17 Dhjetor 2014,

#### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 18 Prill 2007, **Lj. R.**, ka paraqitur kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-banesës që gjendet në Prishtinë, ..., në sipërfaqe prej 71,61 m<sup>2</sup>. Ajo pretendon se ka qenë shfrytëzuese e banesës dhe se të njetën e ka privatizuar. Banesën e ka humbur për shkak rrethanave të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë, duke theksuar datën e humbjes me 12 qershor 1999. Në formularin e kërkesës deklaroi se pronën e ka kërkuar në ish Drejtoratin për Çështje pronësore dhe banesore dhe e pa knaqur me vendimin e Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore paraqet kërkesë për kthimin e posedimit.

2. Kërkesa është regjistruar me numër KPA...,
3. Paraqitësi e kërkesës në mbështetje të kërkesës së vet ai ka paraqitur midis tjerash keto dokumente:
  - Kontrate e blerjes se banës e lidhur në mes të palës ankuese dhe dhenesit të banesës tani Shoqates Aksionare me kapital të përzier DD “...” e lidhur me 01.06.1993 pa klauzole vertetimi ne Gjykatë
  - Aneks Kontrata e blerjes Ov.Br...., të datës 8 Dhjetor 1993, nuk është verifikuar pozitivisht sipas raportit verifikues i AKP-ës i dt. 23 janar 2009.
  - Aktvendim Nr. 22 datë 22 Qershor 1992 i Komisionit për vlerësimin e gjendjes faktike për kushtet e banimit të palës përgjegjese në ankesë. Komisioni i bartësit të së drejtes pronesore Ndermarrja Shoqeoore Gazimenstan nga Prishtina
  - Vendim mbi ndarjen e baneses Nr ..., datë 21 Prill 1993 me të cilin ndermarrja shoqerore i dan pronën e kërkuar palës ankuese n shfrytëzim.
  - Kontrate shfrytezimi i banesës me qira Nr ..., datë 5 Korrik 1995 mes Ndermarrjes Komunale Banesore dhe palës ankuese.
  - Aktvendim mbi anulimin e ndarjes së banesës palës Nr..., datë 13 Prill 1993
4. Më 2 Janar 2008, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti banesor dhe konstatuan që ai shfrytëzohej nga pala përgjegjëse.
5. Pala përgjegjëse në kërkesë, duke marr pjesë në procedurën e AKP-ës, ka pretenduar të drejtën ligjore të kësaj banese duke theksuar se, paraqitësi i kërkesës nuk është titullar i të drejtës pronësore për banesën e kërkuar.
6. Për ta mbështetur pretendimin e tij ka paraqitur këto dëshmi edhe atë:
  - Vendimin e Komisionit të Kërkesave pronësore dhe Banesore HPCC/D/226/2005/A&C të datës 22 Tetor 2005 me të cilin kërkesa e palës përgjegjëse ishte aprovuar dhe mbi bazën e diskriminimit i kthehej prona pa;lës përgjegjëse kurse pala ankuese referohet për kompensim mbi bazën e UNMIK/REG/2000/60 dhe sipas kushteve t’ë Vendimit të Komisionit.

7. Më 17 Dhjetor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KKPK), përmes vendimit të vet KPCC/D/R/270/2014 (në tekstin e mëtejshëm: Vendimi i KKPK-së) ka hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetim të vendimit (paragrafi 20), KKPK-ja ka theksuar se provat e dorëzuara nga pala ankuese, të verifikuara nga Sekretaria Ekzekutive kanë treguar se çështja ishte vendosur me vendim të formës së prerë dhe bazuar në dispozitat e nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 KKPK-ja do ti hedhe kë'rjesat të cilat janë vendosur më parë.
8. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 6 Maj 2015. Më 8 Maj 2015 pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Më 4 Prill 2016i ishte dorëzuar ankesa palës përgjegjëse, megjithatë ajo nuk ka dërguar përgjigje në të.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së është i jashtëligjshëm dhe kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj ankesën dhe të "rivendos gjendjen që ka ekzistuar para konfliktit", pasi që humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar ka ndodhur për shkak të konfliktit të armatosur dhe se në kohën e konfliktit ai ka qenë pronar i banesës objekt i kësaj kërkesë.
10. Pala ankuese gjithashtu nuk pajtohet me konstatimin se KKPK-ja nuk ka juridiksion për çështjet të cilat janë vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor të formës së prerë dhe se bazuar në provat e paraqitura pala ankuese del se është pronare e pa kontestuar e pronës së kërkuar. Ajo pretendon se ka bërë kërkesë për njohjen e të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar dhe se kjo kërkesë nuk është e njëjte me të parën.
11. Pretendimet e palës ankuese janë se ai ka hyrë në marrëveshje me dhënësin e banesës ashtu që ka bërë ndërrim të banesës së mëparshme mbi të cilën ai kishte të drejtë pronësie dhe la marrë në shfrytëzim pronën e kërkuar të cilën sipas ligjeve në fuqi e ka blerë nga ndërmarrja shoqërore.

## **Pranueshmëria e ankesës**

12. Gjkata Supreme shqyrtoi Vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejshëm: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se: Ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për Vendimin.

## **Arsyetimi ligjor**

13. Gjkata Supreme e Kosovës gjeti se vendimi i kundërshtuar i KKPK-së ishte marr pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi një bazë të tillë si e drejta materiale ashtu edhe ajo procedurale janë zbatuar në mënyrën e duhur. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.

14. Gjkata Supreme vlerëson se vendimi ankimor është i drejtë dhe ligjshëm. Drejtë ka vepruar KPCC kur ka vendosur me vendimin ankimor që ta hedh kërkesën e për shkak të çështje së gjykuar apo res judicata sipas nenit 11.4.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC. Kjo ngase, ishte vendosur me vendimin e formës së prerë të HPCC/REC/91/2007 i datës 19 Janar 2007 me të cilin refuzohej kërkesa për rishqyrtim dhe vërtetohej vendimin e Komisionit të Kërkesave pronësore dhe Banesore HPCC/D/226/2005/A&C të datës 22 Tetor 2005 me të cilin kërkesa e palës përgjegjëse ishte aprovuar dhe mbi bazën e diskriminimit i kthehej prona palës përgjegjëse kurse pala ankuese referohej për kompensim mbi bazën e UNMIK/REG/2000/60 dhe sipas kushteve të Vendimit të Komisionit.

15. Çështja ishte gjykuar në themel me Vendimin e Komisionit të Kërkesave pronësore dhe Banesore HPCC/D/226/2005/A&C të datës 22 Tetor 2005. Ndaj ketij vendimi ishin ankuar pala ankuese dhe njëpalë e tretë duke kërkuar rishqyrtimin e Vendimit por Komisioni kishte refuzuar kërkest duke e mbjtur ne fuqi Vendimin e Komisionit të Kërkesave pronësore dhe Banesore shih HPCC/REC/91/2007/ të datës 19 Janar 2007.

16. Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin pretendimet ankimore të ankuesit se banesën kontestuese e ka fituar në rrugë ligjore, gjë që paraqet edhe dokumentet përkatëse të cilat tashmë i ka paraqitur, por gjeti se, të njëjtat pretendime janë pabazuara të papranueshme dhe rrjedhimisht të

kundërligjshme. Kjo ngase, këto pretendime ankimore janë shqyrtuar , vendosur me vendimin e HPCC/D/REC/91/2005 i dt.18 Qershor 2005 kur është vendosur meritorisht.

17. Juridiksioni i Komoisionit (HPCC) buron nga Neni 1.2 i Rregullores se UNMIK-ut 1999/23 që parasheh se Drejtoria i pranon dhe i referon te Komisioni” Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e mëposhtme të kërkesve që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të midis tjerash edhe kategorinë “A) si në nenin 2.2 të Rregullores se UNMIK-ut 2000/60 që parasheh se *“2.2 Çdo person i cili e ka humbur të drejtën në pronë në periudhën ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe datës 24 mars 1999 si pasojë e diskriminimit, ka të drejtë për rikthimin e saj në pajtim me këtë Rregullore. Rikthimi mund të jetë në formë të rivendosjes së të drejtës mbi pronën (më poshtë i quajtur: “kthim në lloj”) ose kompensim”*.
18. Sipas UNMIK/RREG/1999/23 të datës 15 nëntor 1999 për themelimin e Drejtorisë për Çëshjte Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore nenit 2.7 *“Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqytitimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë”*.
19. Sipas nenit 166 të LPK-ës i cili mbi parimin *mutatis mutandis* zbatohet ashtu siç e parasheh neni 13.5 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, nuk lejohet gjykimi i ri në mes palëve të njëjta për çështjen juridike, për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, siç është rasti konkret.
20. Në bazë të gjendjes së tillë të konstatimeve faktike ,Gjykata Supreme vlerëson se, tërësisht dhe saktësisht ekziston identiteti, subjektiv, objektiv dhe e njëjta bazë faktike dhe juridike në mes të vendimit të HPCC/D/REC/48/2007 i dt.18 Qershor 2005 dhe kërkesës së paraqitur në AKP. Prandaj qartazi rezulton konkludimi juridik se kjo çështje është *res judicata*.
21. Vendimi ankimor nuk përmban ndonjë shkelje esenciale apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.

22. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e me zbatim të nenit 13.3.B të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenit 166 par 2 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NE PRISHTINE**

**GSK-KPA-A-023/2016 me datën 12 Qershor 2019**

**Bashkp. Profesional**

**Sherif Krasniqi**

**KRYETARI I KOLEGJIT**

**Beshir Islami**